

## MARRËVESHJA PËR BASHKIMIN E SHOQËRIVE

Në Tiranë sot më datë 17.08.2020, në selinë e shoqërisë "PIK" shpk që ndodhet në Tiranë Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Tiranë, hartohet kjo marrëveshje për bashkimin e kësaj shoqërie me shoqërinë "ZDPUBLICITY Publicity" shpk.

Bashkimi do të kryhet në formën e përthithjes të njërës shoqëri nga një shoqëri ekzistuese.

### 1. Drejtimi i bashkimit

#### a. Shoqëria përthithëse:

"PIK" shpk me NIPT: L12316016A.

Kapitali i regjistruar 100 lekë

Selia: Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Tiranë.

Ortakë:

- Ardit Koleci, që zotëron 20% kuota me vlerë nominale 30,000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
- Alban Fejzaj, që zotëron 40% kuota me vlerë nominale 60,000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
- Glon Bakalli, që zotëron 40% kuota me vlerë nominale 60,000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë

#### b. Shoqëri e përthithur:

"ZDPUBLICITY Publicity" shpk me NIPT L51406004A.



Kapitali i regjistruar 100,000 lekë

Selia: Rruga Sitki Cico, P.2K Nr.213, Tiranë

Ortakë:

- Lediona Bariu, që zotëron 100% kuota me vlerë nominale 100,000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

### 2. Motivet dhe qëllimi i bashkimit.





Qëllimi dhe motivi i bashkimit është menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik e financiar, përdorimi me më shumë efektivitet i mjeteve financiare, zgjerimi i aktivitetit nëpërmjet përthithjes së aktivitetit të Shoqërive, duke realizuar në këtë mënyrë shtimin e produktit të ri, përballimin e konkurrencës në treg dhe për rrjedhojë rezultate më të mira të fitimit. Më poshtë po rendisim aspektet kryesore të këtij bashkimi:

- Shoqëria përfituese e kontributeve ose shoqëria përthithëse në përfundim të këtij procesi do të ruajë emrin shoqëria **"PIK" shpk.**
- Selia e Shoqërisë përfituese të kontributeve do të jetë në **Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Kati 2, Tiranë.**
- Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë të përthithur, "ZPDPUBLICITY PUBLICITY" shpk, mbas përfundimit të operacionit i kalojnë Shoqërisë përthithëse "PIK" shpk.
- Shoqëria e përthithur, "ZPDPUBLICITY Publicity" shpk si shoqëri e përthithur nga shoqëria "PIK" shpk në përfundim të këtij operacioni do të priset pa likuidim duke kaluar plotësisht trashëgiminë e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqëria përthithëse, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
- Data 30.06.2020 do të quhet sipas Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në aspektin e kontabilitetit si data e bashkimit të shoqërive.
- Data 30.06.2020, është data në të cilën janë hartuar pasqyrat financiare për efekt të bashkimit, dhe që janë përdorur për këtë qëllim.

### 3. Aktivet dhe Pasivet e parashikuara për tu bashkuar

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi, shoqëria "ZPDPUBLICITY Publicity" shpk si shoqëri e përthithur, i transferon shoqërisë "PIK" shpk si shoqëri përthithëse, tërësinë e elementëve të aktivitetit dhe të pasivit ashtu si rezultojnë në bilancin e datës 30.06.2020. Elementët e aktivitetit dhe të pasivit që do të kalojnë nga shoqëria e përthithur në shoqërinë përthithëse paraqiten në Pasqyrat Financiare të Bashkimit. Në këtë tabelë paraqitet dhe bilanci i përbashkët dhe mbas realizimit të operacionit të bashkimit.

### 4. Modalitetet dhe raportet e këmbimit të kuotave.



Ortakët e të dy shoqëritë të përfshira në këtë proces bashkimi kanë rënë dakord për kalimin e pasurisë të shoqërisë që përthithet me të drejtat dhe detyrimet përkatëse.

Me vullnet të lirë dhe me marrëveshje mes palëve është rënë dakord të konsolidohen përkatësisht të gjithë Zërat e Bilancit të shoqërisë së përthithur tek Zërat e Bilancit të Shoqërisë Përthithëse.

Gjithashtu edhe përsa i takon Kapitalit është rënë dakord që të mblidhen përkatësisht sikurse ekzistojnë në bilance.

Më vullnet të lirë është rënë dakord që ortakët e Shoqërisë së përthithur të Zotërojnë 40% të Kapitalit të Shoqërisë Përthithëse pas përfundimit të procesit të Përthithjes.



Ky proces i rregullimit të raportit të kapitalit të shoqërisë pas procesit të përthithjes, do të arrihet duke rritur Kapitalin e Shoqërisë nëpërmjet Fitimeve të Pashpërndara të Shoqërisë Përthithëse .

Vlerat përkatëse do të këtij procesi do të përcaktohen me Vendim Asambleje të shoqërive përkatëse dhe konfirmohen e Certifikohen nga Raporti i Ekspertit Kontabël bazuar në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Mbas përfundimit të procedurave të bashkimit do të kemi një shoqëri të vetme "PIK" shpk.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përthithëse pas bashkimit do të jetë 250'000 lekë i përbërë nga :

- Lediona Bariu, që zotëron 40% kuota me vlerë nominale 100'000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
  - Ardit Koleci, që zotëron 12% kuota me vlerë nominale 30'000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
  - Alban Fezaj, që zotëron 24% kuota me vlerë nominale 60'000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
  - Glon Bakalli, që zotëron 24% kuota me vlerë nominale 60'000 lekë dhe që përfaqëson 1 Kuotë të Kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
- Fitimet e pashpërndara të Shoqërisë "PIK" shpk të realizuara deri në datën e Bashkimit të Shoqërive 30.06.2020, përkatësisht sipas Zërave të Pasqyrave Financiare janë objekt i shpërndarjes vetëm për ortakët e Shoqërisë "PIK" shpk



para bashkimit e konkretisht Z. Ardit Koleci me 20%, Z. Alban Fejzaj me 40% dhe Glon Bakalli me 40%.

- Fitimet e pashpërndara të Shoqërisë "ZDPUBLICITY Publicity" shpk të realizuara deri në datën e Bashkimit të Shoqërive 30.06.2020, përkatësisht sipas Zërave të Pasqyrave Financiare janë objekt i shpërndarjes vetëm për ortaken e vetme të Shoqërisë "ZDPUBLICITY Publicity" shpk para bashkimit e konkretisht Z. Lediona Bariu me 100%.
- Shoqëria "PIK" shpk do të destinojë pas përfundimit të vitit ushtrimor dhe miratimit të pasqyrave financiare të çdo viti, të paktën 80% të fitimit pas tatimit, pasi alokimit të rezervave statutore dhe ligjore, automatikisht, përveçse kur votohet me unanimitet ndryshe.

Shoqëria "PIK" shpk gëzon frutet e kontributit të shoqërisë "ZDPUBLICITY PUBLICITY" shpk duke filluar nga data e realizimit të bashkimit në fjalë.

Selia e Shoqërisë përfituese të kontributeve do të jetë Selia: Rruga Pjetër Bogdani Nr.37, Kati 2, Tiranë.

Përfaqësues ligjor i shoqërisë do të jetë Z. Alban Fejzaj.



#### 5. Eksperti Kontabël

Experti kontabël që ka bërë raportin e bashkimit Z. Ilir Daiu me Nr. License 361 me Nipt: L91310004V.

#### 6. Data kontabël

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërive të përfshitura do të merren në librat e shoqërisë përfshirë nga data 30.06.2020 përsa i përket pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga ana tjetër regjistrimi i aktiveve dhe pasiveve në librat e shoqërisë përfshirë do të bëhet sipas bilancit të datës 30.06.2020.

#### 7. Të drejtat dhe avantazhe të veçanta



Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të vecantë .



Ky bashkim hartohet e nënshkruhet në kushtin e varësinë së miratimit nga asambleja e përgjithshme e secilës prej shoqërive pjesëmarrëse pas datës 30.06.2020, përkatësisht me vendimet e datës 17.08.2020.

#### 8. Fuksionimi i Shoqërisë Përthithëse "PIK" shpk

Shoqëria "PIK" shpk do të vazhdojë të funksionojë me Aktin e themelimit dhe Statutin e saj. Objekti i shoqërisë do të bëhet:

- Ofrimi i shërbimeve grafike, dizenjim, editori, dizenjim faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafikes, dizenjim realizime mediatike dhe marrëdhënie me publikun, organizim eventesh, tregti materiale për organizim eventesh ndriçim, foni, dekorime, konsulence për organizim eventesh, ide për marketing dhe të gjitha aktivitetet e tjera financiare të lidhura me përmbushjen e objektit të shoqërisë.
- Agjensi publicitare, marketing, blerje në media, planifikim buxheti mediatik, konsulencë në fushën mediatike, organizim dhe drejtim të aktiviteteve promovionale dhe reklamuese, organizim dhe financim/sponsorizim i eventeve të ndryshme. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, shoqëria mund:
- Të kryej cdo aktivitet publikimi tregtar, financiar , dhënie - marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimin e shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të sipërcituara. – Të kryej aktivitete publikimi dhe reklamimi. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj që lidhen me të dhe që e mbështet atë. Shërbime monitorimi të medias dhe analiza mediatike. Konsulence në menaxhim dhe administrim. Konsulence në plane biznesi profesionale, planifikim financiar, analize konkurrence. Konsulence në fushën e marketingut për zhvillim tregu dhe rritje të shitjeve. Konsulence në zhvillime të produkteve dhe shërbimeve. Konsulence për Web Zhvillim, Internet Marketing, IT Services.

Çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.



9. Pasoja për të punësuarit pas bashkimit.

Marrëdhëniet juridike me të punësuarit e shoqërisë të përthithur, janë mbartur më 01.07.2020 nga shoqëria përthithëse dhe marrëdhënia e punës do të vazhdojë rregullisht edhe pas përfundimit të procesit të bashkimit, deri në përfundim të kontratave të punës të lidhura me të punësuarit.

10. Marrëdhëniet me të Tretët

Marrëdhëniet juridike të shoqërisë së bashkuar me të tretët, (të krijuara para bashkimit), do të mbarten në shoqërinë përthithëse dhe detyrimet që burojnë nga këto kontrata do të përmbushen nga shoqëria përthithëse.

11. Marrëdhëniet me Organet Shtetërore

Marrëdhëniet juridike të shoqërisë së bashkuar me Organet Shtetërore, (të krijuara para bashkimit), do të mbarten në shoqërinë përthithëse dhe detyrimet që do të rezultojnë për shoqëritë e përthithura deri në mbarimin e tyre si person juridik do të përmbushen nga shoqëria përthithëse.

Për shoqërinë "PIK" shpk  
Administratori

Alban Fejzaj



Për shoqërinë "ZPDPUBLICITY PUBLICITY" shpk  
Administratori

Lediona Bariu

